



TURJELA SHTYPËSE



Turjela shtypëse është makinë manuale e cila përdoret për shpimin e vrimave të madhësive të ndryshme, varësisht nga forma e burgisë. Kjo makinë është turjelë e fiksuar e cila mundëson shpimin e materialeve të ndryshme si druri, plastika, metali, materialet kompozite etj. Dallimi kryesor mes turjelës shtypëse dhe një turjele të thjeshtë është saktësia e lartë e mundësuar nga turjela shtypëse e cila mundësohet duke kontrolluar thellësinë dhe drejtimin e shpimit përmes dorëzave të makinës.

Siguria luan një rol kritik në çdo operacion që përfshihet përdorimi i kësaj makine.

Anatomia e Turjelës shtypëse



A: Baza	F: Dorëza për thellësi dhe ndalje	K: Crank Handle Dorëza	P: Chuck Key Holder Mbajtësi i çelësit
B: Mbajtësi i tavolines	H: Motori	L: Column Support Mbajtësi i shtyllës	Q: On/Off Safety Switch Siguresa On/Of
C: Hapësira punuese (Tavolina)	G: Mbrojtësi i rrypit	M: Column Shtylla	R: Quill Return Spring Pulla Rrotë e kthimit

D: Shpatulla	I: Column Collar Rrethi i sigurues i shtyllës	N: Lock Handle Dorëza e bllokuesit	S: Quill & Spindle Rrota & Aksi
E: Leva kontrolluese	J: Column Rack Dhëmbëzori i shtyllës	O: Power Cord Kabloja e rrymës	T: Table Lock Handle Doreza bllokuese e tavolinës
			U: Table Angle Scale & Lock Nut Mbajtësi i tavolinës dhe dadoja mbyllëse

Puna me Turjelën shtypëse

Kontrollimi i turjelës shtypëse ndryshon nga një lloj i turjelës shtypëse në tjetrin, mirëpo një numër i elementeve të përdorimit mbeten kryesisht të njëjta.

Gjatë përgatitjes së makinës për përdorim, duhet të sigurohemi që makina është e shkyçur.

Funksionet bazë të cilat duhet t'i kemi parasysh, para se të fillojmë punën me turjelën shtypëse janë:

1. Caktimi i shpejtësisë

Shpejtësia në shumicën e makinave rregullohet duke lëvizur rripin e makinës nga një rrotull në tjetrin. Në përgjithësi, sa më e shtrënguar, aq më shpejt bëhet lëvizja e kokës.

Një rregull bazike, si me çdo operacion prerës, është se shpejtësitë më të vogla janë më të mira për shpimin e metaleve, ndërsa shpejtësi më të mëdha për materiale nga druri.

2. Palosni copëzat

Para përdorimit duhet të sigurohemi që të gjitha copëzat/pjesët e makinës janë të vendosura mirë. Sidomos shpuarësja, e cila vendoset duke ndjek këto hapa:

- a. Hapeni shpatullën,
- b. Futeni shpuarësën,
- c. Shtrëngoni kokën me qelës

KUJDES: Sigurohuni që po e largoni çelësin, sepse mund të bëhet e rrezikshme kur të ndezim makinën.

3. Rregullimi i hapësirës punuese (tavolinës së makinës)

Turjela shtypëse ka tavolinën fikse, e cila përdoret për të pozicionuar materialet të cilat duam t'i përpunojmë me turjelë. Leva e fiksimit (K) përdoret për të rregulluar lartësinë e tavolinës së turjelës. Kjo levë rregullon lartësinë e hapësirës punuese (tavolinës). Vendosni tavolinën në lartësinë e dëshiruar për të operuar me turjelën shtypëse.

4. Vlerësimi i thellësisë

Nëse jeni thjeshtë duke shpuar një vrimë në një pllakë të drurit, nuk keni nevojë ta rregulloni thellësinë. Por, nëse keni nevojë të shponi vrima deri në thellësi të caktuara ose diçka specifike atëherë duhet të siguroheni që para se të filloni shpimin të bëhet testi I thellësisë duke e kurdisë turjelën shtypëse. Vlerësimi I thellësisë bëhet duke kurdisë dorëzën për thellësi dhe ndalje (F).

5. Siguroni materialin të cilin do ta punoni

Para se të përdorni makinën, sigurohuni që copëza (materiali) që duhet shpuar të jetë i fiksuar në vend. Rrotullimi i turjelës gjatë shpimit mund ta shtyjë materialin punues, prandaj duhet të jetë i fiksuar mirë për hapësirën punuese (tavolinën e makinës).

6. Shpimi

Sapo të përfundojë konfigurimi i turjelës shtypëse, vendosja e saj në punë është e lehtë. Sigurohuni që turjela po rrotullohet me shpejtësi të plotë, dhe pastaj filloni shpimin duke e rrotulluar levën kontrolluese (E). Pasi të keni përfunduar shpimin e vrimës, lirojeni presionin mbi levë dhe mekanizmi do të kthehet në pozicionin original

SIGURIA

Lista e kontrollit për punë të sigurt

Para përdorimit të makinës

- Detyra (p.sh. Vizatimet, udhëzimet, specifikimet etj.) të kuptohen qartë
- Turjela është e shtrënguar dhe nuk lëviz
- Çelësi për shtrëngimin e kokës është i hequr nga makina
- Është vendosur shpejtësia e saktë e rrotullimeve të turjelës.
- Identifikoni butonin On/Off dhe butonin e ndaljes emergjente

Gjatë punës me turjelën shtypëse, evitoni këto situata:

- Mos vishni rroba të shkira ose kollare. Palosni mëngët mbi bërryl për të evituar kapjen e tyre në pjesët lëvizëse.
- Nëse keni flokë të gjata, i lidhni ato
- Mos vëni dorëza, unaza, ora, ose byzylyk gjatë punës me turjelën shtypëse
- Mos ndryshoni shpejtësinë, konfigurimin, ose matjet derisa makina të jetë ndalur plotësisht
- Mos e shtyni kokën e turjelës me presion shtesë
- Mos e leni çelësin e makinës në turjelën shtypëse. Përfundoni përshtatjet dhe largojeni çelësin menjëherë.
- Mos e mbani materialin i cili është në proces të shpimit me dorë gjatë shpimit.
- Mos i vendosni duart përfundim materialit i cili është në proces të shpimit.
- Mos e leni makinën të punojë pa mbikëqyrje
- Mos e largoni turjelën me goditje apo çekiç
- Mos e ndërpritni rrotullimin e turjelës me dorë.

Praktika të mira, për punë të sigurt me turjelën shtypëse:

- Mbani syzet e duhura të sigurisë.
- Sigurohuni që makina e ka butonin Start/Stop lehtësisht të arritshëm
- Përdorni fshesë ose furçë për të larguar mbetjet nga shpimi.

- Përdorni vegla për të siguruar stabilitetin e materialeve
- Sigurohuni që koka e makinës është e shtrënguar mirë. Largoni çelësin para se të filloni me përdorimin e makinës
- Lubrifikoni turjelën para se të shponi materiale metalike.
- Reduktoni presionin e shpimit nëse turjela fillon të thyhet gjatë punës.
- Mbani turjelën të pastër dhe të mprehtë. Turjelat e pa mprehur mirë janë shkak i zakonshëm i thyerjes.
- Mbani hapësirën rreth turjelës të pastër nga vaji dhe yndyrat.
- Mbani sipërfaqen e punës të pastër nga mbetjet, mjetet dhe materialet